



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:158795
Datë: 13.12.2024
Numri i dokumentit: 06592495

Pml.nr.716/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit A. S., nga P., për shkak të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 273, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.182/2019, të datës 15.05.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.490/2024, të datës 23.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 05.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A. S., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.182/2019, të datës 15.05.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.490/2024, të datës 23.10.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.182/2019, të datës 15.05.2024, i dënuari A. S., është shpall fajtor për shkak të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 273, paragrafi 1 të KPRK-së dhe ndaj tij është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej një mijë (1.000) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Dënimin me gjobë të shqiptuar, i dënuari mund ta paguajë me tre (3) këste më së largu deri më datën pesë (5) të muajit vijues

dhe jo më larg se tre (3) muaj nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, konform nenit 43 të KPRK-së, ndërsa mundësia e pagesës me këste do të revokohet, nëse i dënuari nuk e paguan këstin me kohë.

Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë si në pjesën e lartcekur të dispozitivit të aktgjykimit, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku njëzet (20) euro të dënimit me gjobë do të barazohen me një (1) ditë burgim.

Është detyruar i dënuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëqind (100) euro, ndërsa për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimin shumë prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Për shpenzimet tjera eventuale, gjykata do të vendos me aktvendim të posaçëm pas llogaritjes së tyre.

Është konfiskuar substanca narkotike e llojit “*Kokainë*”, me peshë të përgjithshme prej 2.61 gram, ndërsa është urdhëruar Policia e Kosovës që këtë substancë narkotike ta shkatërrojë sipas procedurave ligjore.

Janë konfiskuar shuma e parave në vlerë prej njëqindëzet (140) euro dhe tre (3) euro – monedha metalike. Paratë e konfiskuara nga i dënuari, përmes Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, në bazë të nenit 23, paragrafi 1 të Ligjit 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i dorëzohen për ruajtje Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, derisa vendimi të marrë formën e prerë. Paratë e konfiskuara në shumën e lartcekur bëhen pronë publike dhe ruhen në mënyrën e përcaktuar me aktin e ministrisë kompetente për punët e financave.

Gjithashtu, është konfiskuar telefoni “*Samsung J6+*”, me kartelë të “*IPKO*” dhe telefoni “*Nokia*”, me kartelë të “*VALA*”, ndërsa me këto sende do të administrojë Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.490/2024, të datës 23.10.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A. S., avokati Arsim Bilalli, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.9. dhe 1.10. lidhur me neni 369, paragrafët 6 dhe 7 të Kodit të Procedurës Penale (KPP); shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. të KPP-së; shkeljeve të ligjit penal, nga neni 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal nga neni 387, paragrafi 1 lidhur me paragrafin 4 të KPP-së, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që t'i ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që i dënuari të shpallet fajtor për shkak të veprës penale “*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*, nga neni 275 i KPRK-së apo

t'i anulojë aktgjykimet në fjalë dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.407/2024, e datës 21.11.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. të KPP-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i paqartë dhe kontradiktor, në të nuk janë përshkruar faktet dhe elementet që e përbëjnë figurën e veprës penale, në veçanti nuk është konstatuar dhe vërtetuar qëllimi i shitjes nga ana e të dënuarit A. S. dhe identifikimi i blerësit që ka pasur për qëllim për ta blerë substancën narkotike, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit në fjalë nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme, duke i pasur parasysh kërkesat ligjore nga dispozita e nenit 369, paragrafët 7 dhe 8 të KPP-së,

Përndryshe, nga shkresat e lëndës mund të shihet se Policia e Kosovës e ka paraqitur kallëzimin penal ndaj të dënuarit A. S., për shkak të veprës penale "Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge", nga neni 275, paragrafi 1 të KPRK-së, por që as Prokurori i Shtetit dhe as gjykatat nuk i janë referuar fare këtij kallëzimi penal.

Gjithashtu, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë mbështetur në prova të papranueshme, duke ju referuar këtu masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, të cilat kanë të bëjnë me datat 17.05.2017 dhe 10.01.2018, e jo për vitin 2019, ndërsa në anën tjetër, asnjëherë nuk është administruar si provë dëgjimi i CD-së, ku është bërë përgjimi i numrit të kinse telefonit të të dënuarit A. S., duke e pasur parasysh se në këtë rast, sipas aktvendimit për fillimin e hetimit, hetimet kanë filluar edhe ndaj: R. M., P. N., Xh. S., S. NN dhe V. NN, andaj edhe me të drejtë është shtruar si pyetje se cili nga këto persona e kanë poseduar numrin e telefonit që është përgjuar sipas masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit.

Sipas mbrojtësit të të dënuarit, me aktgjykimet e kundërshtuara është edhe shkelur ligji penal, pasi që gabimisht është konstatuar se në veprimet e të dënuarit A. S., qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën është shpall fajtor, duke qenë se bëhet fjalë për substancë narkotike në peshë prej 2.6 gram, të cilën i dënuari e ka poseduar me qëllim të konsumimit personal.

Përveç këtyre, gjykata e shkallës së dytë nuk ka arritur që të vlerësojë drejt pretendimet ankimore të mbrojtësit, por me një konkludim të përgjithësuar ka konstatuar se pretendimet janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shikimit dhe analizimit të shkresave të lëndës konstatoi se pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë nuk përfshihen me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë përpiluar në formën e parashikuar me ligj, pasi që përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas nenit 369 dhe nenit 404, paragrafi 1 të KPP-së, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsyetimit.

Edhe pse në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është specifikuar konkretisht se ku qëndrojnë paqartësitë dhe kundërthëniet e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vërejtur që dispozitivi i aktgjykimit në fjalë të jetë i paqartë apo kundërthënës në ndonjë pjesë.

Në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme është paraqitur vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari A. S., së bashku me të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme që e përbëjnë figurën e veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 273, paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal, duke përfshirë këtu edhe qëllimin e të dënuarit për ta shitur apo shpërndarë substancën narkotike, ashtu siç parashihet në nenin 369, paragrafi 4 lidhur me nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së.

Gjithashtu, edhe në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del që janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta për të gjitha çështjet e rëndësishme, ashtu siç parashihet në nenin 369, paragrafët 6, 7 dhe 8 të KPP-së. Në këtë aspekt, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar në mënyrë të qartë dhe të plotë, përveç çështjeve tjera, edhe dashjen dhe qëllimin e të dënuarit, si element të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, si dhe është vlerësuar në mënyrë të veçantë saktësia e provave kundërthënëse, duke përfshirë këtu edhe deklarimet e të dënuarit, në raport me provat tjera të nevojshme që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, në veçanti në raport me transkriptet e bisedave telefonike që janë siguruar përmes masave të veçanta hetimore.

Nga vetë deklarimi të dënuarit A. S., gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, rezultoi i pa kontestuar fakti se i njëjti e kishte poseduar në mënyrë të paautorizuar substancën narkotike të llojit “Kokainë”, në peshë prej 2.61 gram, të cilën, kishte pretenduar se e kishte poseduar me qëllim të përdorimit personal, ndërsa nga provat tjera rezultoi se kjo substancë narkotike, pas kontrollit nga ana e zyrtarëve policor, të dënuarit i është gjetur në xhepin e xhakëtës, më datën 08.03.2019, rreth orës 21:15 minuta, në rrugën “Ilir Konushevi”, në Prishtinë (sipas të dënuarit, në parkingun të “Xhamia e Llapit”) dhe se kjo substancë narkotike kishte qenë e ndarë në gjashtë (6) paketime, të mbështjella me najlon.

Po ashtu, arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë përfshin edhe rrethanat përkatëse lehtësuese dhe rëndësuese të cilat janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimeve.

Përveç aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, siç është theksuar edhe më parë, me shkelje të pretenduara nuk është përfshirë as aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ngase në të janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta në lidhje me vlerësimin e pretendimeve thelbësore ankimore të mbrojtësit të të dënuarit. Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, del që gjykata në fjalë i ka vlerësuar të gjitha pretendimet thelbësore të mbrojtësit që janë paraqitur në drejtim të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionet penale, si dhe për të gjitha këto pretendime, ka paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta.

Edhe pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit në lidhje me papranueshmërinë e provave, konkretisht masave të veçanta hetimore, vlerësohet si i pabazuar dhe se Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet në tërësi me arsyetimet dhe sqarimet e gjykatave të instancave më të ulëta, pasi që në këtë rast këto masa janë lëshuar nga gjyqtari kompetent i gjykatës së shkallës së parë, në bazë të procedurës së parashikuar me ligj dhe se fillimisht këto masa kanë patur vlefshmëri për gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita kur është marrë urdhri PN.KR.nr.86/2017, i datës 18.05.2017 dhe mandej, janë ripërtërirë edhe me urdhrin e datës 02.11.2017, nga ka rezultuar se i dënuari kishte biseduar me persona të ndryshëm lidhur me shitblerjen e narkotikëve, ku i dënuari shihet qartë se ishte marrë me këtë veprimtari dhe madje ishin caktuar edhe detaje tjera në lidhje me narkotikët, duke përfshirë këtu: cilësinë e narkotikëve, sasinë, çmimin, vendin dhe kohën e dorëzimit, etj. dhe kjo periudhë kohore përfshinë edhe periudhën kohore pas marrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve. Mbi bazën e të gjitha këtyre të theksuarave, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vërejtur ndonjë paligjshmëri në këtë drejtim, e cila më pastaj do të mund të rezultonte në papranueshmërinë e këtyre provave.

Në anën tjetër, fakti se në kallëzimin penal të Policisë së Kosovës është përcaktuar një veprë penale tjetër, në raport me veprën penale për të cilën është zbatuar hetimi, ngritur aktakuza dhe shpallur fajtor i dënuari, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës është i parëndësishëm dhe nuk ka ndonjë ndikim në ligjshmërinë, si të aktakuzës, ashtu edhe të aktgjykimeve të kundërshtuara.

Gjithashtu, nuk qëndron as pretendimi i mbrojtësit se është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit A. S., pasi që veprimet e të dënuarit, të përshkruara në mënyrë të hollësishme në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i përbëjnë të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 273, paragrafi 1 të KPRK-së, siç me të drejtë kanë konstatuar edhe gjykatat e instancave më të ulëta, duke i pasur parasysh rrethanat specifike të rastit konkret.

Siç kanë arsyetuar edhe gjykatat e instancave më të ulëta, dashja dhe qëllimi i të dënuarit A. S., si elemente të figurës së veprës penale për të cilën është shpallur fajtor janë vërtetuar nga

rrethanat faktike të këtij rasti, duke u bazuar në nenin 22 të KPRK-së. Kështu, nga shkresat e lëndës dhe nga bisedat e transkripteve të përgjimeve, të cilat janë të paraqitura në mënyrë hollësisht në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, pavarësisht që i referohen një periudhe të më hershme kohore, i dënuari ishte marrë me veprimtarinë e shitjes dhe të shpërndarjes së narkotikëve, siç është theksuar edhe më lart. Në anën tjetër, pavarësisht se bëhet fjalë për një sasi jo të madhe të substancës narkotike (2.61 gram), nga shkresat e lëndës del që i dënuari këtë sasi të substancës narkotike të llojit “Kokainë”, e kishte poseduar në mënyrë të paautorizuar në orët e vona të mbrëmjes në një vend publik, të cilin e kishte ndarë në gjashtë (6) paketime e të cilat paketime kanë qenë në mbështjella në najlon.

Andaj, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, në njërin anë, kurse në anën tjetër, duke e pasur në konsideratë edhe rrethanat tjera specifike të rastit, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se arsyetimet dhe sqarimet e gjykatave të instancave më të ulëta në lidhje me dashjen dhe qëllimin e të dënuarit, si elemente të figurës së veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, janë të drejta dhe gjejnë mbështetje në shkresat e lëndës dhe në rrethanat faktike të këtij rasti. Të gjitha këto që u theksuan më lart, janë rrethana që shpijnë në përfundimin se dashja dhe qëllimi i të dënuarit, kishte qenë shpërndarja ose shitja e substancës narkotike, andaj edhe pretendimit e mbrojtësit të të dënuarit nuk qëndrojnë.

Përndryshe, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se për tu konsideruar se është kryer vepra penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 273, paragrafi 1 të KPRK-së nuk është e domosdoshme që kryesi të takohet duke shitur apo shpërndarë substanca narkotike, apo edhe të dihet se kush është konkretisht blerësi, por që e rëndësishme dhe e mjaftueshme, në kuptim të figurës së kësaj vepre penale është që kryesi “të posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge”.

Në fund, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur edhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale nga neni 387 i KPP-së, mirëpo, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se konform nenit 432 të KPP-së, ky mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk mund të ushtrohet për të vendimit lidhur me sanksionet penale, andaj edhe rrjedhimisht pretendimet e tilla nuk janë shqyrtuar fare.

Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.716/2024, më datë 05.12.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Mejreme Memaj